

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 22, DATË 12.1.2018 ‘PËR MIRATIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT DHE NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/OBJEKTEVE NË FUNKSION TË TIJ’”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndërmarrja e nismës për rishikimin dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 22/2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, ka si qëllim rritjen ekonomike në zonat rurale nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, duke mundësuar lehtësimin e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor për rregullimin e veprimtarisë së agroturizmit.

Me ndryshimet e propozuara do të zgjerohet fasha e aktiviteteve tregtare që do të ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmi, duke nxitur përfshirjen në këtë aktivitet edhe të bizneseve familjare e më të vogla si dhe duke shtuar llojet e veprimtarive agroturistike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2023 dhe është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Agroturizmi dhe turizmi natyror janë veprimtari të cilat kanë një potencial të lartë zhvillimi për zonat rurale në Shqipëri. Në zonat rurale, në vend, kanë filluar të funksionojnë ferma që ofrojnë shërbime në agroturizëm të cilat kanë arritur në një kohë të shkurtër rezultate shumë të mira ekonomike dhe sociale.

Gjatë kësaj periudhe janë certifikuar 24 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë *Agroturizëm* dhe 17 subjekte u pajisën me certifikatë paraprake për agroturizëm.

Është evidentuar një interes në rritje nga sipërmarrës, të cilët kërkojnë të investojnë kapitalet e tyre në fushën e agroturizmit me gamë të gjerë veprimtarish bujqësore/blegtorale.

Sa më sipër, u mor nisma për rishikimin e kuadrit ligjor me fokus lehtësimin e procedurave dhe zgjerimin e veprimtarive agrikulturore që do të përfshijë agroturizmi.

Ofrimi i masave lehtësuese do të rrisë interesin për të investuar në agroturizëm në struktura të reja si dhe në struktura ekzistuese (shtëpitë e kthyer në bujtina) në zona rurale, duke sjellë rritje ekonomike dhe punësim, sidomos për gratë.

Në këtë kuadër, fasha e aktiviteteve tregtare që do të ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit do të përfshijë edhe njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitete akuakulturën, bletërritjen dhe përpunimin e produkteve.

Me qëllim nxitjen e zhvillimit të agroturizmit edhe në struktura familjare, për subjektet të cilat ofrojnë akomodim, numri minimal i dhomave është ulur duke u zëvendësuar me 6-60 shtretër, ndërsa numri i vendeve të uljes në restorant është kufizuar nga 10-80. Ky reduktim është në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në zonat rurale.

Me qëllim gjithëpërfshirjen, është parashikuar zhvillimi i agroturizmit edhe në njësi më të vogla të menaxhuara në nivel familjar, për subjektet që kanë të kategorizuar strukturën akomoduese si bujtinë, janë përcaktuar kritere më të lehta krahasuar me kategoritë e tjera.

Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018 "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave /objekteve në funksion të tij", i ndryshuar.

Për subjektet e pajisura me certifikatën paraprake të agroturizmit, të cilët nuk kanë përfunduar ndërtimin e strukturës brenda afateve të përcaktuara, nëse nuk kanë ndonjë dokument justifikues nga organet përgjegjëse, është propozuar të kthejnë incentivën e përfituar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe Ligjin Nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIV)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i propozuar parashikon realizimin e disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe konkretisht:

Në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në tekstin e projektvendimit, fjala “çlodhëse” zëvendësohet me fjalën “edukative”.
2. Pika 2.2 e Kreut I, ndryshon si më poshtë vijon:
“2.2 Agroturizmi duhet të zotërojë një fermë bujqësore/blegtorale/njësi agrikulturore dhe të ofrojë aktivitete argëtuese/edukative, shërbimin e ushqimit dhe akomodim”.
3. Shkronja “a” dhe “c” e pikës 4, të Kreut II, ndryshon si më poshtë vijon:
“a) Fermat bujqësore, të cilat kanë të paktën 1 ha tokë, në pronësi ose përdorim, në funksion të mbjelljes me kultura bujqësore.

Relacion për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave /objekteve në funksion të tij”, i ndryshuar.

c) Njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitet:

(i) përpunimin e produkteve bujqësore dhe të paktën 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore (subjekti duhet të ketë edhe një ambient për përpunimin e produkteve bujqësore);

(ii) përpunimin e produkteve blegtorale dhe të mbarështojnë të paktën 10 krerë gjedhë ose 100 krerë dele/dhi; Subjekti duhet të ketë edhe një ambient për përpunimin e produkteve blegtorale si p.sh.: qumësht, djathë, kos, mjelja e lopëve, deleve;

(iii) akuakulturën sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi mbi akuakulturën. Subjektet të kenë në pronësi, ose përdorim me kontratë qiraje/huapërdorje sipërfaqe ujore jo më të vogël se 3000 m². Subjekti duhet ta përdori këtë sipërfaqe për kultivimin dhe rritjen e peshkut/midhjes;

iv) bletërritjen dhe prodhimin e mjaltit dhe të kenë të paktën 50 zgjoje bletësh dhe parkun e bletëve ose bletishtën; Subjekti duhet të ketë në pronësi/përdorim një ambient për vendosjen e bletëve si dhe për mbledhjen dhe prodhimin e nënprodukteve të mjaltit”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me përmbajtjen si vijon:

“4.1 Përyjashtimisht, për subjektet që kanë të kategorizuar strukturën akomoduese si “bujtinë”, agroturizmi mund të zhvillohet minimalisht edhe në:

a) fermat bujqësore, të cilat kanë të paktën 1 ha tokë, në pronësi ose përdorim, të mbjella me kultura bujqësore;

b) ferma blegtorale, të cilat mbarështojnë, të paktën, 5 krerë gjedhë ose 50 krerë dele/dhi ose 100 krerë shpendë;

c) njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitet bletërritjen dhe prodhimin e mjaltit me të paktën 30 zgjoje bletësh”.

5. Në pikën 7, togfjalëshi “... 6 deri në 30 dhoma”, zëvendësohet me togfjalëshin “... nga 6 deri në 60 shtretër”.

6. Në pikën 8, pas shkronjës “a”, shtohet shkronja a/1 me përmbajtje si vijon: “a/1) në varësi të llojit të strukturës/objektit, kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Vendimin Nr. 711, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese”.

7. Në pikën 10, togfjalëshi “... 6 deri në 60 tavolina.”, zëvendësohet me togfjalëshin “... 10 deri në 80 vende uljeje”.

8. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me përmbajtje si vijon:

Relacion për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave /objekteve në funksion të tij”, i ndryshuar.

“19/1. Subjektet e pajisura me “Certifikatë Paraprake”, të cilët nuk kanë përfunduar ndërtimin e strukturës brenda afateve të miratuara nga Komisioni duhet të paraqesin brenda 60 ditëve nga dita e përfundimit të afatit, dokumentin që vërteton shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit lëshuar nga autoriteti përgjegjës. Në rast të kundërt, subjekti kthen në buxhetin e shtetit shumën e përfituar nga legjislacioni në fuqi për agroturizmin, brenda 90 ditësh nga afati i përfundimit të Certifikatës Paraprake”.

9. Pas pikës 21, të Kreut IV, shtohet pika 21/1 dhe 21/2, me përmbajtje si vijon:
“21/1 Aplikimet e paraqitura në ministrinë përgjegjëse për turizmin përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të shqyrtohen sipas kriterëve dhe kushteve të parashikuara në këtë vendim”.

“21/2 Subjektet e pajisura me “Certifikatë Paraprake”, të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së certifikatës përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të paraqesin brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, dokumentin që vërteton shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit lëshuar nga autoriteti përgjegjës. Në rast të kundërt, subjekti derdh në buxhetin e shtetit shumën e përfituar nga legjislacioni në fuqi për agroturizmin, brenda 90 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”.

Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

1. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

2. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi u hartua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe t'u dërgohet për mendim më Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.

3. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektakti nuk do të ketë nevojë për shpenzime buxhetore shtesë nga buxheti i shtetit dhe nuk do të sigurojë të ardhura buxhetore shtesë.

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA

**MINISTRI I I TURIZMIT
DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 22, datë 12.1.2018 "Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave /objekteve në funksion të tij", i ndryshuar.